



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2026

**VENDIM**  
**Nr. 171, datë 09.04.2026**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES GENTIANA**  
**XHELILI PËR PERIU DHËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Gentiana Xhelili, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Violanda Theodhori,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares Gentiana Xhelili, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI I PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A Njohuritë ligjore

#### *1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

*Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes pasqyron procedurën e ndjekur nga gjykata dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues (elementë të cilët analizohen në çdo vendim), evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) njoftimin e Avokaturës së Shtetit (në zbatim të nenit 79/a të K.Pr.Civile),<sup>1</sup> (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për shtimin apo saktësimin e objektit të padisë,<sup>2</sup> (iii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për saktësimin e emrit të personit të tretë<sup>3</sup> apo thirrjen në gjykim të personit të tretë,<sup>4</sup> (iv)*

---

<sup>1</sup>Vendimet nr.911, datë 17.09.2019, nr.1076, datë 21.10.2019, nr.359, datë 19.03.2019, nr.458, datë 11.04.2019, nr.907, datë 13.09.2019, nr.1255, datë 18.10.2018, nr.1556, datë 23.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>2</sup>Vendimet nr.1222, datë 19.11.2019, nr.552, datë 23.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>3</sup>Vendimi nr.409, datë 24.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>4</sup>Vendimi nr.526, datë 14.04.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

ecuria procedurale e gjykimit në rastet kur çështja është dërguar për kompetencë lëndore nga një gjykatë tjetër,<sup>5</sup> etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i identifikuar ato, në një nënndarje të titulluar “*Rrethanat e çështjes*”.

Përshkrimi i rrethanave të faktit të provuara në gjykim bëhet duke i ndërthurur me provat shkresore, aktin e ekspertimit dhe provat e tjera të marrë gjatë gjykimit, duke evidentuar dhe elementët e faktit që kanë rezultuar si të provuar nga vlerësimi tërësor i tyre. Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrihen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit. Elementë të këtyre të fundit, gjenden të pasqyruara dhe në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të evidentuara si të tilla në vendim në një pjesë tjetër të dallueshme për lexuesin. Analiza e fakteve të çështjes mungon vetëm në vendimin në të cilin gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale (*pushimin gjykimi*),<sup>6</sup> në të cilën gjyqtarja nuk referon dhe analizon elementë të faktit, por merr drejtpërdrejt në analizë shkakun procedural që i ka dhënë fund gjykimit.

***Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes***, në vendimet e analizuara evidentohet se, gjyqtarja identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese gjyqtarja analizon juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes.

Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin administrativ, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, detyrim për dëmshpërblim, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, shfuqizimin e aktit administrativ dhe detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit, si dhe orienton në vijim arsyetimin ligjor.

***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se pas pasqyrit të fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit të Punës, të Kodit Doganor dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht në vendimet burim vlerësimi, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

---

<sup>5</sup>Vendimi nr.409, datë 24.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>6</sup>Vendimi nr.1325, datë 17.10.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

- nenin 36 të K.Pr.Civile, nenet 7, 10 dhe 11 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësor të gjykatës; nenin 8/3 të ligjit nr.9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” në lidhje me nenet 7, 10, 11 të ligjit 49/2012, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes;<sup>7</sup> nenet 4 dhe 7 të Kodit të Punës lidhur me kompetencën tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt marrëdhënie pune;<sup>8</sup> nenin 36/1, 41 dhe 511 të K.Pr.Civile në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e kërkesës me objekt lëshim urdhër ekzekutimi;<sup>9</sup> nenin 12 të ligjit nr.49/2012 në lidhje me përbërjen e trupit gjykues;<sup>10</sup> nenin 79/a dhe 125 të K.Pr.Civile lidhur me njoftimin e akteve Avokaturës së Shtetit.
- nenet 15 dhe 17 të ligjit 49/2012 në lidhje me legjitimitetin apo jo të palës paditëse;
- nenin 6 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me kontratat administrative; nenet 850, 863, 420, 421, 463, 446, 690, 698 të Kodit Civil lidhur me kontratën e sipërmarrjes, lindjen dhe ekzekutimin e detyrimeve, fuqinë e kontratës dhe pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve.<sup>11</sup>
- nenet 107, 108 dhe 109 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me pavlefshmërinë absolute dhe paligjshmërinë e aktit administrativ.<sup>12</sup>
- nenin 193 të K.Civil lidhur me regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të vendimeve të gjykatave dhe të organeve kompetente shtetërore që përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.<sup>13</sup>
- nenin 282 të Kodit Doganor në lidhje me ankimin ndaj vendimit të autoriteteve doganore, nenin 261 të Kodit Doganor të vitit 1999, në fuqi në kohën e kryerjes së deklarimit doganor, në lidhje me cilësimin si kundërvajtje administrative doganore të deklarimit të ndryshëm nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, dhe nenin 287 në lidhje me përmbajtjen e dosjes në rastet e shkeljeve të evidentuara. Nenet 107 dhe 109 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me ligjshmërinë e aktit administrativ.<sup>14</sup>
- nenin 12 të K. Punës lidhur me marrëdhënien juridike të krijuar midis palëve ndërgjyqëse; nenet 141, 143, 144, 153 dhe 155 të Kodit të Punës lidhur me afatin e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën, zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, shkakun e justifikuar, pasojat e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar.<sup>15</sup>

<sup>7</sup> Vendimi nr.458, datë 11.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>8</sup> Vendimi nr.688, datë 16.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>9</sup> Vendimet nr.295, datë 14.05.2019, nr.104, datë 16.04.2018 dhe nr.137, datë 15.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>10</sup> Dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore referohen në çdo vendim burim vlerësimi

<sup>11</sup> Vendimi nr.1222, datë 19.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>12</sup> Vendimet nr.234, datë 16.02.2017 dhe nr.1391, datë 08.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>13</sup> Vendimet nr.552, datë 23.04.2018 dhe nr.526, datë 14.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>14</sup> Vendimi nr.911, datë 17.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>15</sup> Vendimi nr.688, datë 16.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

- nenin 32/c të K.Pr.Civile me qëllim vlerësimin e legjitimitetit aktiv dhe interesit të palës paditëse në ngritjen e padisë; nenet 27, 38, 40, 41, 42, 43, 45, 57/7, 57/8 dhe 57/9 të ligjit nr.10129, datë 10.04.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, lidhur me aktin e lindjes, regjistrimin e aktit të lindjes dhe kërkesën për korigjimin e emrit dhe mbiemrit, dokumentet që i bashkëlidhen dhe procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës.<sup>16</sup>
- nenin 245/4 të Kodit Doganor, në funksion të vlerësimit se vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantueses dhe /ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, përben titull ekzekutiv.<sup>17</sup>
- nenin 510 të K.Pr.Civile, në lidhje me ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në funksion të përcaktimit të titullit ekzekutiv dhe legjitimitit të palës kërkues për ngritjen e kërimit për lëshimin e urdhrin ekzekutiv.<sup>18</sup>
- nenet 35 dhe 37 të ligjit nr.49/2012 me qëllim përcaktimin e barrës së provës, nenin 106 të K.Pr.Administrative lidhur me formën që duhet të marr një akt administrativ, nenin 100 të K.Pr.Administrative lidhur me arsyetimin e aktit administrativ.<sup>19</sup>
- nenin 201 të K.Pr.Civile dhe nenin 39 të ligjit 49/2012 në lidhje me të drejtën e paditësit për të hequr dorë nga gjykimi dhe pasojën juridike të pushimit të gjyqimit, nenin 45 të ligjit 49/2012 lidhur me vendimet e paankimueshme.<sup>20</sup>

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- nenin 6 të ligjit 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, lidhur me detyrimet e personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura, nenet 23 dhe 24 të këtij ligji, lidhur me kundërvajtjet administrative dhe masat e gjobës për kundërvajtjet administrative dhe sanksione të tjera.<sup>21</sup>
- nenet 1, 3 dhe 10/2 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, në lidhjen me kriteret për vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë dhe procedurat për titujt e pronësisë, të krijuar në kundërshtim me ligji. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.255. datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.<sup>22</sup>
- nenin 6 të ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, në fuqi në kohën që ka lindur e drejta

<sup>16</sup> Vendimet nr.921, datë 06.07.2018 dhe nr. 886, datë 09.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Dispozitat e ligjit 10129, datë 10.04.2009 “Për gjendjen civile” citohen edhe në vendimin nr.1478, datë 13.11.2017

<sup>17</sup> Vendimi nr.295, datë 14.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>18</sup> Vendimet nr.104, datë 16.04.2018 dhe nr.137, datë 15.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>19</sup> Vendimi nr.642, datë 21.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>20</sup> Vendimet nr.911, datë 17.09.2019, nr.1296, datë 23.10.2018, nr.1391, datë 08.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>21</sup> Vendimi nr.1076, datë 21.10.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>22</sup> Vendimi nr.234, datë 16.02.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

për pension të parakohshëm. VKM nr. 409, datë 01.06.2016 “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve” në funksion të analizës së ky vendim nuk parashikon se ndryshimi i masës së pensionit përfshin dhe pensionet suplementare.<sup>23</sup>

- nenet 26 dhe 27 të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në lidhje me funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit. Dispozitat e ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (nenet 1, 5, 7, 13, 17, 22, 47, 48, 49 dhe 50), me qëllim përcaktimin e konceptit të “autoritetit publik”, zbatimin e parimit të parandalimit dhe detyrimin për marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit. Po kështu, lidhur me të drejtën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, mbrojtjen e ujërave, hartimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin, të drejtën për akses në informacion mjedisor dhe për t’iu drejtuar gjykatës, si dhe përgjegjësinë dhe sanksionet në rast të dëmtimit të mjedisit.<sup>24</sup>
- nenet 1, 11, 14, 19, 20 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, në funksion të përcaktimit të organeve të qeverisjes vendore, si organi kompetent për licencimin e shoqërive tregtare me shumicë dhe autorizimet për shoqëritë që tregtojnë me pakicë që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve nga konsumator fundorë.<sup>25</sup>
- nenet 24, 25, 26, 27 dhe 32 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me qëllim përcaktimin e kuptimi të regjistrimit fillestar, mënyrën dhe ligjërimin e regjistrimit fillestar; nenin 32 lidhur me detyrimin ligjor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.<sup>26</sup>
- dispozitat e ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar dhe ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” i ndryshuar, si kuadri ligjor i zbatueshëm për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, në funksion të analizës se padia është ngritur kundrejt një palë që nuk gëzon legjitimet pasiv.<sup>27</sup>
- nenet 1, 3, 22, 25, 36, 68 dhe 69 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, me qëllim sqarimin e kuptimit të termave “gjurmim” dhe “etiketim”, përcaktimin e përgjegjësive për higjienën ushqimore, kërkesat lidhur me gjurmueshmërinë e ushqimeve, kërkesat e përgjithshme për etiketimin e ushqimit, kundërvajtjet administrative, si dhe vendimin përfundimtar të

---

<sup>23</sup> Vendimi nr.1296, datë 23.10.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>24</sup> Vendimi nr.359, datë 19.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>25</sup> Vendimet nr.1391, datë 08.11.2018 dhe nr.526, datë 14.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>26</sup> Vendimet nr.552, datë 23.04.2018 dhe nr.907, datë 13.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>27</sup> Vendimi nr.409, datë 24.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

Inspektorit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në lidhje me shqyrtimin e këtyre shkeljeve.<sup>28</sup>

- nenet 2, 3, 5 dhe 6 të ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin për burgim të padrejtë”, në lidhje me të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë, rastet kur konsiderohet se ka ndodhur burgim i padrejtë, si dhe masën e kompensimit që përfitohet në këto raste.<sup>29</sup>

*Sa i përket konfliktit të normave*, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Ajo ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes***

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi, si dhe me pretendimet dhe prapësimet e palëve, referon, citon dhe, në disa raste, interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshme mbi faktet konkrete, në funksion të analizës ligjore dhe në mbështetje të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes.

<sup>28</sup> Vendimi nr.1255, datë 18.10.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>29</sup> Vendimi nr.458, datë 11.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

Në përgjithësi, në vendimet e vëzhguara, normat ligjore citohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes. Në disa raste, kur është vlerësuar e nevojshme nga gjyqtarja, ato shoqërohen me interpretim të kuptimit të tyre, përpara aplikimit mbi faktin konkret në shërbim të të cilit analizohen dispozitat përkatëse, në shërbim të mbështetjes së konkluzionit të gjyqtarja lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja:

- interpreton nenin 6 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i cili ka qenë në fuqi në momentin që paditësit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm, me qëllim analizimin e të drejtës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.<sup>30</sup>
- interpreton në mënyrë literale nenin 108 të K.Pr.Administrative me qëllim përcaktimin e kriterëve të vlefshmërisë së aktit administrativ: i) kompetenca, ii) procedura, iii) përputhja e aktit me përmbajtjen e ligjit, iv) përputhja e aktit me qëllimin e ligjit.<sup>31</sup>
- Interpretëson nenin 144 të Kodit të Punës lidhur procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi. Po kështu interpreton në mënyrë sistematike nenet 141 dhe 143 të K.Punës lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës në kontratën me afat të pacaktuar, si dhe afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Interpretëson nenet 153 dhe 155 të K.Punës lidhur me shkaqet e justifikuara në zgjidhjen e kontratës së punës si dhe pasojat e zgjidhjes së menjëhershme dhe në mënyrë të pajustificuar të marrëdhënies së punës.<sup>32</sup>
- Interpretëson në mënyrë sistematike nenin 6 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me kontratat administrative si dhe nenet 850, 863, 420, 421, 463, 446, 690, 698 të Kodit Civil lidhur me kontratën e sipërmarrjes, lindjen dhe ekzekutimin e detyrimeve, fuqinë e kontratës dhe pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve.<sup>33</sup>
- interpreton nenet 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ligjit nr.9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, mbi kushtet ligjore dhe mënyrën e kompensimit në rastet e kompensimit për burgim të padrejtë, që në thelb përfaqëson detyrimin e shtetit për të dëmshpërblyer financiarisht një person për shkak të cenimit në kundërshtim me ligjin të të drejtave dhe lirive të tij themelore, heqjes apo kufizimit të paligjshëm të lirisë personale, që i referohen faktit të mbajtjes në rrethana paraburgimi apo burgimi për një periudhë kohore në kundërshtim me kriteret ligjore.<sup>34</sup>
- interpreton në mënyrë sistematike nenet 22 dhe 24 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, për të konkluduar lidhur me

<sup>30</sup> Vendimi nr. 1296, datë 23.10.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>31</sup> Vendimi nr. 1193, datë 12.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>32</sup> Vendimi nr. 688, datë 16.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>33</sup> Vendimi nr. 1222, datë 19.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>34</sup> Vendimi nr. 458, datë 11.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të dënimit administrativ, për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit.<sup>35</sup>

- interpreton nenin 245/4 të Kodit Doganor për të konkluduar lidhur me kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të rikuperimit me forcë të borxhit doganor, për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit.<sup>36</sup>

Në lidhje me normat procedural, gjyqtarja ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpreton nenet 7 germa “a” dhe 15 germa “a” të ligjit organik nr.49/2012 me qëllim vlerësimin e interesit të ligjshëm dhe legjitimitetit aktiv të palës paditëse.<sup>37</sup>
- interpreton nenin 35 të ligjit organik nr.49/2012, në drejtim të përcaktimit të barrës së provës në gjykimin administrativ.<sup>38</sup>

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, në vendimin nr. 642, datë 21.05.2019, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për të nxjerrë aktin administrativ”, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, gjyqtarja i është referuar konkretisht vendimit nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese në mbështetje të interpretimit të “*së drejtës për akses në gjykatë*”, si një e drejtë e patjetërsueshme, e pandashme dhe e padhunueshme, pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar gjithashtu nga neni 6 i Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***, rezulton se gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet e së drejtës materiale të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi.

---

<sup>35</sup> Vendimet nr. 137, datë 15.05.2017 dhe nr. 104, datë 16.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>36</sup> Vendimi nr. 295, datë 14.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>37</sup> Vendimi nr. 1222, datë 19.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

<sup>38</sup> Vendimi nr. 1193, datë 12.11.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B. Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuar, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në gjykim, nuk rezultojnë përdorimi i termave latine, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe. Termat teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezultojnë se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet janë të organizuara në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga

njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në mënyrë të qëndrueshme në çdo rast. Ajo tregon një metodologji të qartë për strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje të identifikuara me tituj që orientojnë qartë përmbajtjen e secilës pjesë.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i mosmarrëveshjes administrative, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtarja:

- (i) ndalet në analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, përbërjen e trupit gjykues, si dhe në evidentimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. shtimin/saktësimin e objekti të padisë, apo thirrjen në gjykim të personit të tretë, etj.
- (ii) *Rrethanat e faktit*, pjesë në të cilën gjyqtarja përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar i provuar në gjykim.
- (iii) *Prendimet dhe prapësimet e palëve* – në këtë pjesë gjyqtarja parashtron në mënyrë të detajuar pretendimet dhe prapësimet e secilës palë, duke i shoqëruar me argumentet e tyre.
- (iv) *Arsyetimi ligjor*, në të cilën gjyqtarja fillimisht citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik dhe e aplikon atë mbi rrethanat konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi zgjidhjen e çështjes.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim

të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), si dhe disponimin mbi shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshme.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.<sup>39</sup>

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj, provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarës për provueshmërinë e fakteve konkrete. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi spikat aftësia e gjyqtarës në drejtim të analizës së provave, e cila zë peshën më të madhe të arsyetimit të vendimeve, analizë që bazohet në arsye dhe logjikë.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet kujdesi që gjyqtarja tregon në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

<sup>39</sup>Vendimi i GJEDNJ, çështja “Hadjanastassiou kundër Greqisë”.

Kryesisht në çështjet me natyrë komplekse, gjyqtarja analizon dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkimet objekt padie ose pretendimet e palës së paditur, me faktin e provuar në gjykim, si dhe me argumentin ligjor konkret. Në këto vendime evidentohet lidhja shkak-pasojë mes fakteve të provuara dhe konkluzionit të arritur. Shprehja e mendimit juridik organizohet në rrjedhë logjike dhe shoqërohet me konkluzionin e pasojën përkatëse që derivon nga analiza ligjore respektive. Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, gjyqtarja i kushton vëmendje pretendimeve dhe prapësimeve që ajo i konsideron të bazuara në ligj dhe në prova në mbështetje të zgjidhjes së çështjes. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, jo në një pjesë të veçuar të arsytimit, por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, këto të fundit marrin një përgjigje të argumentuar, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit të vendimit.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i*

*cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon e vetme ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## **2.A. Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë**

### **2.A.a Respektimi i afateve ligjore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore,<sup>40</sup> për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 146 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (94 çështje në vitin 2017, 33 çështje në vitin 2018 dhe 19 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin dy kategorive “Administrative me palë kundërshtare” dhe “Administrative pa palë kundërshtare”.

Duke iu referuar objektit të çështjeve pasqyruar në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbarimore” për të cilat neni 610 paragrafi i tretë<sup>41</sup> i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor, dhe me objekt “Sigurim padie”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 28, pika 3<sup>42</sup> të ligjit nr.49/2012 duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 146 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 80 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (80 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (146 çështje), **sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 54.79% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmblodhur se një nga prioritetet kryesore të punës së saj ka qenë zhvillimi i proceseve brenda afatit të arsyeshëm, përmes një menaxhimi efektiv të dosjeve nga momenti i shortimit deri në shpalljen e vendimit të arsyetuar. Ajo thekson se ka synuar zhvillimin e veprimeve procedurale në distancë, duke komunikuar paraprakisht qëndrimet, aktet dhe kërkesat e palëve, me qëllim rritjen e efikasitetit të seancave gjyqësore, si dhe ka garantuar respektimin e të drejtave themelore të palëve, duke u treguar njëkohësisht strikte ndaj kërkesave të pabazuara që zvarrisin procesin. Gjyqtarja ka deklaruar se ka zbatuar në mënyrë rigorozë afatet procedurale të përcaktuara në Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke evidentuar se

<sup>40</sup> Dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. 111 prot., datë 18.02.2021, si dhe ridërguar nëpërmjet postës elektronike nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, më datë 30.04.2025

<sup>41</sup> Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se: “Veprimet e kryerja nga përmbaruesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile”. Ndërkohë neni 601, paragrafi 3 i K.Pr.Civile parashikon se: “Ankimi shqyrtohet **brenda 20 ditëve** nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor”.

<sup>42</sup> Neni 28 pika 3 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se “Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet **brenda 5 ditëve** nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në rastet e ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët”.

rastet e tejkalimit të afatit të arsyeshëm lidhen kryesisht me natyrën komplekse të çështjeve (si realizimi i ekspertimeve), kërkesat procedurale të palëve, nevojën për sigurimin e provave nga gjykata, si dhe me çështje që kanë qenë në pezullim, për të cilat ajo ka kryer periodikisht veprime verifikimi mbi vazhdimësinë e shkakut të pezullimit. Ajo ka parashtruar gjithashtu se gjatë periudhës 2017–2019 ka kaluar probleme të rënda shëndetësore, duke iu nënshtruar pesë ndërhyrjeve kirurgjikale, por pavarësisht kësaj është përpjekur të mos shtyjë proceset dhe të përfundojë gjykimet brenda një afati të arsyeshëm, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës shëndetësor dhe kërkesat drejtuar organeve kompetente për leje dhe mosdelegim. Ndër faktorët që, sipas saj, kanë ndikuar në zgjatjen e disa proceseve, ajo ka përmendur edhe veprimet e paligjshme të sekretares gjyqësore, e cila është deklaruar fajtores me vendim gjyqësor për vepra penale që lidhen me falsifikim dokumentesh, shpërdorim detyre dhe zhdukje të fashikullit gjyqësor, duke sjellë pasoja në mbarëvajtjen e proceseve. Së fundi, gjyqtarja ka sqaruar se në disa raste shtyrjet kanë ardhur si pasojë e veprimeve të shumta procedurale, si dhe për shkak të periudhave të planifikuara pa seanca (dy javët e para të muajit janar për mbartjen e dosjeve dhe muaji gusht për lejen vjetore).<sup>43</sup>

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 80 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, evidentohet se në disa raste vonesa në shqyrtim është tejkaluar me afate të papërfillshme, ndërsa në raste të tjera tejkalimi paraqitet më i konsiderueshëm. Konkretisht:

- Për çështjet me numër rendor 19, 20, 23, 24, 26, 35, 36, 37 dhe 48 (Tabela 2, viti 2017), me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, rezulton se vendimi është dhënë brenda 6 ose 7 ditëve, duke tejkaluar afatin ligjor përkatësisht me 1 ose 2 ditë. Këto tejkalime vlerësohen si të papërfillshme dhe, për pasojë, ***këto 9 (nëntë) çështje do të konsiderohen të shqyrtuara brenda afatit ligjor.***
- Për çështjet me numër rendor 121, 148 (Tabela nr.2, viti 2018) dhe numër rendor 166, 177 (Tabela nr.2, viti 2019), me objekt “Sigurim padie”, rezulton se vendimi është dhënë brenda 8 ose 7 ditëve, duke tejkaluar afatin ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 28, pika 3, të ligjit nr.49/2012, respektivisht me 3 dhe 2 ditë. Këto tejkalime vlerësohen si të papërfillshme, duke marrë në konsideratë edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përllongaritjen e afatit. ***Për pasojë, këto 4 (katër) çështje do të konsiderohen të shqyrtuara brenda afatit ligjor.***

Në lidhje me afatin e gjykimet në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen brenda 20 ditëve, në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

---

<sup>43</sup> Parashtrimet e plota të gjyqtares paraqiten në Raportin Analitik

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e afatit deri në 10 ditë sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.49/2012;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbartuesit gjyqësor dhe lënien e afatit deri në 10 ditë për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave, sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr.49/2012;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t’u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përlogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbartuesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji.

Nëse afati ligjor i shqyrtimit të çështjeve me këtë objekt do të ishte i njëjtë me afatin maksimal që Kodi i Procedurës Civile parashikon për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, atëherë afati do të konsiderohej i tejkaluar në 22 çështje, të cilat janë shqyrtuar respektivisht për 47, 57, 67, 92, 94, 54, 47, 77, 147, 85, 114, 67, 147, 277, 71, 47, 48, 106, 53, 56, 78 dhe 77 ditë. Ndërkohë, për 18 çështjet e tjera, konkretisht ato me numër rendor 60, 243, 248, 262, 285, 330, 331, 421, 425, 426 (Tabela nr. 1, viti 2017); 122, 142, 147, 152 (Tabela nr. 2, viti 2018); si dhe nr. 62, 70, 173, 212 (Tabela nr. 1, viti 2019), të cilat janë gjykuar përkatësisht për 44, 35, 38, 36, 27, 39, 35, 39, 39, 45, 42, 42, 31, 44, 31 dhe 36 ditë, pra në më pak se 45 ditë.

Sa më sipër, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës si më sipër, rezulton të jetë 49 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (49 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (146 çështje), gjyqtarja **rezulton që të ketë gjykuar 33.5% të çështjeve tej afatit ligjor.**

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 6 (gjashtë) pikë. Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë

çështjesh në periudhën e vlerësimit, në total ka gjykuar 1750 çështje, nga të cilat 1239 çështje me palë kundërshtare,<sup>44</sup> duke kaluar standardin sasior të punës me 175%.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konkretisht:

- a) pamundësisë për të respektuar në të gjitha rastet afatin ligjor 20-ditor, për shkak të veprimeve procedurale të nevojshme për t'u kryer në kuadër të gjykimit administrativ, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrave procedurale të organit publik (personit fizik apo juridik që ofron një shërbim publik);
- b) ngarkesës së lartë të gjyqtarës, duke pasur parasysh se gjatë periudhës së vlerësimit ajo ka përfunduar 1239 çështje me palë kundërshtare;
- c) vetëvlerësimit të gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- d)

umrit të çështjeve me afat ligjor, konkretisht 146 çështje, të cilat përbëjnë rreth 8% të totalit të çështjeve të shqyrtuara prej saj gjatë periudhës së vlerësimit; vlerësoj se, për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me nivel më lart se niveli që do t'i korrespondonte vetëm përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se kjo përqindje rezulton 33.5%. Në përcaktimin e pikëzimit për këtë tregues, vlerësuesi mbështetet në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, në raport me detyrueshmërinë ligjore që një kategori e caktuar çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Megjithatë, pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i kufizuar i çështjeve me afat gjykimi (në total 146, nga të cilat 49 janë shqyrtuar jashtë afatit), gjyqtarja duhet të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në trajtimin me përparësi të këtyre çështjeve.

n

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarës, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 12 pikë.*

### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, duke iu referuar standardit minimal kohor 1 muhor të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së,<sup>45</sup> rezulton se nga **1604** çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet

<sup>44</sup> Sipas pikës 3 shkronja "c", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative

<sup>45</sup> Në pikën 5 shkronja "c" të "Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore", miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se: "Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj."

standardi minimal kohor, **1144** prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë **71.32%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtarja në Formularin e Vlerësimit ka bërë prezent disa nga shkaqet të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të tilla si: natyra komplekse e gjykimit administrativ për shkak të objekteve të padive, që shpesh diktojnë nevojën e kryerjes së një apo disa akteve ekspertimi në të njëjtin proces; paraqitja e qëndrimeve dhe provave nga palët në kufijtë maksimalë të afateve procedurale, duke sjellë shtyrje të seancave për garantimin e së drejtës së mbrojtjes; si dhe kufizimet infrastrukturore të gjykatës, përfshirë ndarjen e sallës së gjykimit me një gjyqtare tjetër, çka ka bërë që disa veprime procedurale të zhvillohen në zyrë dhe të kërkojnë më shumë kohë administrative. Ajo ka theksuar se, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, është shfuqizuar afati 30-ditor i parashikuar më parë, ndërkohë që referuar nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, afat i arsyeshëm në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel konsiderohet përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Në këtë kuadër, ajo vlerëson se ka respektuar afatet minimale kohore dhe se shpejtësia e gjykimit ka qenë në nivel shumë të mirë. Gjithashtu, është evidentuar se afati 30-ditor është realizuar në çështje më të thjeshta, si ato që lidhen me kundërvajtjet administrative (p.sh. shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor) apo raste që procedohen vetëm mbi bazën e akteve shkresore. Sipas statistikave, çështjet që kanë zgjatur më tepër janë ato që kanë kërkuar hetim më të thelluar dhe administrim provash të specializuara. Në përfundim, gjyqtarja ka nënvizuar se çdo çështje ka specifikat dhe kompleksitetin e vet, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kohën e nevojshme për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatën mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të

palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 të K.Pr.Civile për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, **gjkimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh.** Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 (një) muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Referuar afatit 87 ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 1604 çështje të gjykuara për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje matematikore, **359 prej tyre ose 22.38% e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati.**

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 359 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e kryerjes së lejes vjetore nga gjyqtarja gjatë muajit gusht (35 ditë), si edhe për shkak të procedurës së mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore në fund të vitit (15 ditë). Nëse këto periudha nuk do të përfshiheshin në përlllogaritjen e afatit të gjykimit, një pjesë e këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohore. Konkretisht,

***Për kategorinë “Administrative me palë kundërshtarë”, (Tabela nr.1) rezulton se:***

- Çështjet me numër rendor 5, 15, 20, 64, 70, 74, 112, 127, 138 (viti 2017), 33, 49, 55, 68, 69, 86, 96, 98, 111, 120 (viti 2018) dhe 8, 10, 14, 26 (viti 2019) kanë përfunduar respektivisht në 92, 103, 96, 96, 91, 98, 98, 101, 99, 99, 92, 96, 99, 98, 95, 102, 103, 102, 103, 92, 95, 98 dhe 96 ditë, duke tejkuluar standardin minimal kohor me 5 deri në 16 ditë. Këto tejkalime konsiderohen të papërfillshme, pasi në të gjitha këto raste kohëzgjatjen e gjykimit e ka ndikuar periudha e fundvitit, e cila përkon me mbartjen e dosjeve nga administrata gjyqësore. ***Për këto arsye, këto 23 (njëzet e tre) çështje përlllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor të pranuar prej 87 ditësh.***
- Çështjet me numër rendor 342, 343, 346, 347, 353, 361, 362, 370, 374, 396, 409 (viti 2017), 229, 232, 233, 234, 238, 239, 240, 242, 245, 246, 247, 249, 250, 251, 253, 259, 264, 265, 266, 267, 268, 270, 276, 279, 283, 284, 286, 289, 293, 295, 299, 308, 311 (viti 2018) dhe 176, 178, 179, 180, 181, 183, 184, 185, 186, 188, 209, 224, 229, 231, 259, 261, 262, 269, 272 (viti 2019) i janë caktuar

gjqtares në muajt maj, qershor ose korrik dhe kanë përfunduar në muajt shtator, tetor ose nëntor. Duke hequr periudhën e lejes vjetore prej 35 ditësh, të gjitha këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor. ***Për këto arsye, këto 63 (gjastëdhjetë e tre) çështje përllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor të pranuar prej 87 ditësh.***

***Për kategorinë “Marrëdhënie pune”, (Tabela nr.3) rezulton se:***

- Çështjet me numër rendor 18, 20 (viti 2017) dhe 9 (viti 2018) i janë caktuar gjyqtares në muajt maj, qershor ose korrik dhe kanë përfunduar në muajt shtator, tetor ose nëntor. Duke hequr periudhën e lejes vjetore prej 35 ditësh, të gjitha këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor. ***Për këto arsye, këto 3 (tre) çështje përllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor të pranuar prej 87 ditësh.***

Nëse në përllogaritjen e çështjeve që janë shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor do të përjashtoheshin edhe 89 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, duke zbritur periudhën e lejes vjetore ose të mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit, rezulton se **nga 1604 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 270 prej tyre, ose rreth 16.8%, kanë tejkaluar këtë standard.**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sipas një llogaritje vetëm matematikore, përqindja e mësipërme e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, pikëzohet me 4 pikë. Por, referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit.<sup>46</sup> Në rastin konkret, sa i përket treguesit sasior të punës së gjyqtares, rezulton se për periudhën e vlerësimit gjyqtarja ka përfunduar në total 1750 çështje në cilësinë e relatores, nga të cilat 1239 çështje janë me palë kundërshtare, pra 175%<sup>47</sup> më shumë se treguesi sasior i përcaktuar në Vendimin nr.261/2 të vitit 2010, çka tregon për një numër të lartë çështjesh të përfunduara, pavarësisht ngarkesës.

## **KONKLUZIONI**

**Për sa më sipër**, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87 ditë dhe jo 1 muajt;
- b) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 16.8%;

<sup>46</sup>Në Metodologjinë e Pikëzimit, sa i përket këtij treguesi, parashikohet se: “*Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal*”.

<sup>47</sup>Në pikën 53/c të Vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 parashikohet: “Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë:....c) Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, ***i seksionit administrative jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative***”.

- c) vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- d) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019, gjatë të cilit gjyqtarja ka përfunduar 1750 çështje, nga të cilat me palë kundërshtare janë 1239 çështje, pra 175% më tepër se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së;
- e) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është më e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”, pavarësisht përqindjes së mësipërme (*e cila vlerësohet me 4 pikë*), për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 16.8% i çështjeve jashtë standardit minimal 87/ditor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, si dhe rezultojnë se gjyqtarja, pavarësisht ngarkesës, ka përfunduar më shumë se 50% të standardit sasior në fuqi.*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi (1 muaj) sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjyqësore, është më e gjatë se standardi për dy prej tre kategorive të çështjeve. Krahasimi për efekt të vlerësimit, do të bëhet duke iu referuar standardit minimal kohor 87 ditë për çështjet me palë kundërshtare, referuar arsytimit të bërë më sipër në treguesin 2.A.b.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje (i) për kategorinë “Çështje administrative me palë kundërshtare” është **78.4 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor 87 ditë); (ii) për kategorinë “Çështje administrative pa palë kundërshtare” është **14.6 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi prej 1/muaj); dhe (iii) për kategorinë “Marrëdhënie pune” është **61.2 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor 87/ditë).

Duke iu referuar arsytimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për tre kategoritë e çështjeve, është më e shkurtër se afati 87 ditor.

### **KONKLuzioni**

Mbështetur në të njëjtën analizë si në treguesin më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, rezultojnë se

koha mesatare është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve, e cila, sipas Metodologjisë, pikëzohet me 5 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve për gjykimin administrativ, dhe për këtë arsye pikëzohet me 5 pikë.*

#### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit, si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1750 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1725 çështje) brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, është **101.44%**.

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, meqenëse rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën mbi 99%, atëherë gjyqtarja për këtë tregues pikëzohet me 10 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 42, pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- (i) Për çështjet e kategorisë “Çështje administrative me palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsyetimit është 10 ditë, **pra e gjatë** se afati procedural i posaçëm i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- (ii) Për çështjet e kategorisë “Çështje administrative pa palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsyetimit është 7 ditë, **pra e barabartë** me afatin procedural të posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- (iii) Për çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune” rezulton koha mesatare e arsyetimit është 7.9 ditë. Tejkalmi i afatit procedural është me 0.9 ditë, një tregues i papërfillshëm, i cili nuk përbën një ditë të plotë kalendarike; për rrjedhojë, do të konsiderohet praktikisht **i barabartë** me afatin procedural të posaçëm prej 7 ditësh, të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zëvendëskryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se bazuar në të dhënat statistikore, rezulton se shumicën e rasteve gjyqtarja ka respektuar afatin e arsytimit të vendimit. Gjithashtu, gjyqtarja argumenton se ndonëse ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në nenin 42/3 parashikon afatin 7-ditor nga shpallja e vendimit për dorëzimin e dosjes në sekretari – një afat shumë i shkurtër – ajo në shumicën e rasteve ka respektuar këtë detyrim, siç rezulton nga të dhënat statistikore. Ajo thekson se respektimi i këtij afati ka kërkuar sakrificë të konsiderueshme, me synimin për të garantuar njëkohësisht edhe cilësinë e vendimmarrjes. Për rastet e pakta kur afati nuk është respektuar, shkak kanë qenë ngarkesa e lartë në punë, gjendja shëndetësore gjatë periudhës përkatëse, si edhe veprimet arbitrare dhe të paligjshme të sekretares gjyqësore E.Sh. Në mbështetje të këtyre pretendimeve gjyqtarja referon vendimin penal nr. 166, datë 18.04.2023 të Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i lënë në fuqi me vendimin datë 08.02.2024 të Gjykata e Apelit Vlorë, për deklarimin fajtores të sekretares gjyqësore E.Sh.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

## **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, pasi për një kategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me 0.9 ditë çka e bën atë të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë dhe për një prej tyre afati procedural i arsytimit është tejkaluar me 3 ditë, ndërkohë që për kategorinë tjerë afati i arsytimit rezulton i barabartë me afatin procedural. Por ky tejkalim afati vetëm një kategori çështjesh, si dhe kohëzgjatja e këtij tejkalimit, sipas Metodologjisë justifikojnë në rastin konkret zbatimin e një niveli më të lartë pikëzimi bazuar në koeficientin 20%, me pasojë pikëzimin me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë*

## **2.B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore**

### ***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive***

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi të dhënat e

pasqyruara nuk përmbajnë vetëm numrin e seancave gjyqësore, por numrin e përbashkët të tyre me seancat përgatitore.<sup>48</sup> Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave të plota për numrin e seancave gjyqësore, analiza është mbështetur në dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin çështjeve me palë kundërshtare. Sipas Raportit Analitik, duke përjashtuar 3 çështje pa palë kundërshtare, rezulton se janë zhvilluar gjithsej 50 seanca, prej të cilave 18 seanca përgatitore dhe 32 seanca gjyqësore. Në këto kushte, numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje rezulton **1.7 seanca**.

Gjyqtarja, në vetëvlerësimin e saj lidhur me këtë tregues, ka parashtruar se vlerëson të ketë treguar aftësinë e duhur për kryerjen e procedurave gjyqësore efektive për çdo kategori çështjesh. Ajo ka shpjeguar se është e kuptueshme që çështjet me natyrë komplekse, si ato në fushën e doganave, tatimeve, shpërblimit të dëmit etj., kanë marrë një kohë më të gjatë shqyrtimi dhe janë planifikuar e zhvilluar me më shumë seanca, ndërkohë që çështje të tjera janë përfunduar me dy seanca. Gjithashtu, ka theksuar se seancat jo produktive kanë qenë shumë të rralla dhe kanë ndodhur kryesisht në rastet e mosrealizimit të njoftimeve të rregullta për palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit ligjorë, duke u treguar gjithnjë e kujdesshme që shpejtësia e gjykimit të mos cenohet cilësinë dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor në gjykimin administrativ.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët.

---

<sup>48</sup> Nga verifikimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 1 me aktet e dosjeve gjyqësore rezultojnë mospërputhje në lidhje me numrin e seancave gjyqësore. Konkretisht, për vitin 2017: çështja me nr. rendor 73 paraqitet në tabelë me 5 seanca gjyqësore, ndërkohë nga analiza e dosjes (vendimi nr. 234, datë 16.02.2017) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 4 seanca gjyqësore; çështja me nr. rendor 387 paraqitet me 2 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 1325, datë 17.10.2017) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore; çështja me nr. rendor 425 paraqitet me 2 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 1478, datë 13.11.2017) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore; çështja me nr. rendor 448 paraqitet me 3 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 1556, datë 23.11.2017) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore. Po kështu, për vitin 2019: çështja me nr. rendor 120 paraqitet me 2 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 458, datë 11.04.2019) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore; çështja me nr. rendor 176 paraqitet me 3 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 886, datë 09.09.2019) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore; çështja me nr. rendor 180 paraqitet me 2 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 907, datë 13.09.2019) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore; si dhe çështja me nr. rendor 184 paraqitet me 3 seanca gjyqësore, ndërkohë nga dosja (vendimi nr. 911, datë 17.09.2019) rezulton se është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore, etj.

Konstatohet se nga ana e gjyqtares merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproductive dhe numri mesatar i seancave në masën 1.7 vjen për shkak të dhënies kohë palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare apo për shpalljen e vendimit.

## **KONKLUZIONI**

Referuar sa më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 18 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është **1.7 seanca** dhe gjyqtarja në të gjitha çështjet (*me palë kundërshtare*) ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 1.7 seanca dhe gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, dhe përgjithësisht brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e paraqitjes së padisë,<sup>49</sup> në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.49/2012. Thuhet “në përgjithësi” pasi në gjastë raste veprimet përgatitore janë zhvilluar përtej këtij afati, konkretisht pas 12,<sup>50</sup> 9,<sup>51</sup> 14,<sup>52</sup> 15,<sup>53</sup> 9<sup>54</sup> dhe 9<sup>55</sup> ditësh.

<sup>49</sup>Neni 25 i ligjit 49/2012 “Veprimet përgatitore” parashikon se “1. **Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime:** a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë. b) I njofton të paditurin padinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, të listës së personave, që i padituri kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre, si dhe të akteve të plota shkresore, në të cilat janë bazuar kryerja e veprimit administrativ dhe shqyrtimi i ankimit administrativ. Në rastin e padisë me të meta, gjyqtari e dërgon këtë njoftim për të paditurin, në datën e plotësimit të të metave nga paditësi. c) Merr vendim për kryerjen e ekspertimit kur çmon se për zgjidhjen e çështjes ka nevojë për njohuri të posaçme. Në këtë vendim ai përcakton fushën e ekspertimit, ekspertin nga lista e gjykatës, detyrat përkatëse, si dhe afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull, nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë...”

<sup>50</sup>Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 474, datë 10.04.2018, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 21.02.2018 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtares në datë 22.02.2018.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25, pika 1 të ligjit nr.49/2012 duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim dhe provave, gjyqtarja ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, liston provat shkresore të paraqitura nga pala si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkakun për caktimin e seancës përgatitore. Në dosjet e vëzhguara, në çështjet me palë kundërshtare është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relativitetin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca është zhvilluar në mungesë të palës paditëse gjyqtarja ka relatuar provat shkresore që janë paraqitur nga pala paditëse bashkëlidhur kërkesëpadië.<sup>56</sup>

---

Veprimet përgatitore, referuar vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen”, janë kryer më datë 05.03.2018, pra 12 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

<sup>51</sup>Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 886, datë 09.09.2019, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 08.05.2019 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtarës në datë 09.05.2019. Veprimet përgatitore, referuar datës së përpilimit të njoftimeve të gjeneruara nga sistemi ICMIS, rezulton të jenë kryer më datë 17.05.2019. Ndërkohë, në vendimin “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen” evidentohet një lapsus në datën e kryerjes së këtyre veprimeve, pasi ato mbajnë datën 06.06.2019, në një kohë kur seanca për kryerjen e veprimeve përgatitore është caktuar më datë 03.06.2019. Në këto kushte, si datë e kryerjes së veprimeve përgatitore do të merret data e përpilimit të njoftimeve për palët për seancën përgatitore, pra data 17.05.2019. Për rrjedhojë, nga data e paraqitjes së padisë deri në datën e kryerjes së veprimeve përgatitore rezulton se kanë kaluar 9 ditë.

<sup>52</sup> Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 911, datë 17.09.2019, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 23.05.2019 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtarës në datë 27.05.2019. Veprimet përgatitore, referuar vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen”, janë kryer më datë 06.06.2019, pra 14 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

<sup>53</sup>Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 907, datë 13.09.2019, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 22.05.2019 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtarës në datë 23.05.2019. Veprimet përgatitore, referuar vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen”, janë kryer më datë 06.06.2019, pra 15 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

<sup>54</sup> Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 234, datë 16.02.2017, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 18.10.2016 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtarës në datë 24.10.2016. Veprimet përgatitore, referuar vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen”, janë kryer më datë 27.10.2016, pra 9 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

<sup>55</sup> Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 1641, datë 21.12.2018, rezulton se ajo është regjistruar në gjykatë më datë 30.10.2018 dhe, me short elektronik, i është caktuar gjyqtarës në datë 31.10.2018. Veprimet përgatitore, referuar vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen”, janë kryer më datë 08.11.2018, pra 9 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

<sup>56</sup>Çështja me nr.921 vendimi, datë 06.07.2018 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.Civile, në çështjet me palë kundërshtarë, gjyqtarja ka disponuar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në çështjet e vëzhguara, kjo seancë nuk është caktuar gjithmonë brenda afatit ligjor 15-ditor të parashikuar në nenin 27, pika 1, të ligjit nr. 49/2012. Evidentohet se në disa raste seanca gjyqësore është përcaktuar pas 18, 22, 35 apo 64 ditësh, por këto vonesa lidhen kryesisht me lejen vjetore në muajin gusht, ose me procesin e mbartjes së dosjeve nga administrata.

Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, i pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3, të ligjit nr. 49/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore dhe përgjithësisht janë mbajtur me regjistrim audio. Ato janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera, përfshirë verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijenie për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përlegjura; shpalljen e gjykatës dhe dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat dhe elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas debatit mbi provat; deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke respektuar afatin procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.Civile; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar; dhe tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar ose shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar, brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore, ndërsa seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet

procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

## **2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore**

### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën renditje të dokumenteve. Renditja e akteve është bërë sipas një rendi logjik, duke respektuar kategoritë e akteve dhe rendin kronologjik brenda së njëjtës kategori, ndërthurur me veprimet procedurale të gjykatës. Kjo mënyrë e renditjes ndiqet kryesisht në të gjitha dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin procedural të shortit, padinë, aktet e përfaqësimit, provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë dorëzuar me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, vendimin mbi kryerjen e veprimeve paraprake, procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore dhe vendimin gjyqësor përfundimtar. Kjo mënyrë e renditjes e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe e përshtatshme për shqyrtim nga gjykata më e lartë.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, rezultojnë se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezultojnë se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (padiat, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e dokumentimit të

veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare, vendimet për pranimin e ankimit).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A. Etika në punë**

##### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren Gentiana Xhelili, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2017-2019, ndaj gjyqtares rezulton të jenë paraqitur 5 (pesë) ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 968/1 prot, datë 13.04.2023, nr. 2286/1 prot., datë 24.07.2023, nr. 827/11 prot., datë 27.07.2023, nr.2431/1 prot., datë 12.09.2023 dhe nr. 2826 prot, datë 21.10.2024 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesa e shtetasit E.B., depozituar në ish-KLD me nr. 517 prot, datë 07.02.2018, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 367 prot, datë 29.01.2021, konsiston në pretendimet për mos respektim të Kodit të Etikes në komunikim me palën e paditur gjatë shqyrtimit të çështje me numër (31159-01419-84-2017) 1538/124 akti, datë 15.08.2017 regjistrimi, përfunduar me vendimin nr. (84-2018-22) 35, datë 15.01.2018. ILD, pas verifikimit të ankesës, me vendimin nr. 968/1 prot, datë 13.04.2023 duke arsyetuar se nuk ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor nga gjyqtarja znj.Gentiana Xhelili, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronjat “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe se praktika e verifikimit të ankesës së shtetasit E.B., për të cilën ka filluar verifikimi me vendimit nr.517/2 prot., datë 03.07.2018 “Për verifikimin e ankesës së shtetasit E.B. ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjykatës Gentiana Xhelili të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, nga Inspektorati pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.367 prot., datë 29.01.2021, duhet të arkivohet bazuar në nenet 117 dhe 122, pika 4 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

II- Informacioni periodik i Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, depozituar në ish-KLD në datën 10.04.2018, është përcjellë pranë Zyrës së ILD duke u regjistruar me nr. 1572 prot, datë 26.02.2021, nëpërmjet të cilit raportohen vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara për muajin Mars 2018 nga gjyqtarja Gentiana Xhelili. ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas verifikimit të praktikës, me vendimin nr. 2286/1 prot, datë 24.07.2023 duke arsyetuar se: *“Vonesat e shkaktuara në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara kanë ardhur për shkak të ngarkesës së lartë në punë të gjyqtarit, nuk kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe nuk kanë ulur besimin e publikut, kompleksiteti i çështjeve nuk ka qenë i nivelit të tillë që të justifikonte vonesën e gjyqtarit në dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara, nuk u provua se ka pasur shkaqe shëndetësore apo personale të cilat lidhen drejtpërdrejtë me gjyqtarin, megjithatë këto vonesa nuk kane sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë....Lidhur me prezencën në punë të gjyqtareve, rezulton se: a) Gjyqtarja Gentiana Xhelili ka qenë prezent në punë dhe nuk ka patur miratime lejeje apo raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë....Nga sa më sipër, vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara janë shkaktuar nga mbingarkesa në punë e gjyqtareve, fakt të cilin e ka konstatuar edhe Këshilli i lartë Gjyqësor në Raportin Vjetor të viti 2018, pra nuk mund të pretendohet për shkelje disiplinore nga gjyqtarët Getinana Xhelili dhe B.Sh...Duke qenë se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit mbi bazën e informacionit periodik të Kryetarit të Gjykatës ndaj veprimtarisë së magistratëve Gentiana Xhelili dhe B.Sh., me detyrë gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “d” të ligjit nr. 96/2016 dhe për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet sipas neneve 117 dhe 122, pika 4 të këtij ligji”.*

III- Ankesa e gjyqtarit K.Dh., e depozituar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2429 prot., datë 09.08.2018, është përcjellë për trajtim në ILD, ku është regjistruar me nr. 911 prot., datë 16.02.2021. Referuar vendimit nr. 827/11 prot., datë 27.07.2023,

rezulton se gjyqtari K.Dh. ka informuar ish-KLD mbi një problematikë të krijuar në gjykimin e çështjes administrative me palë paditëse F.M., duke pretenduar se gjatë gjykimit pala paditëse kishte paraqitur kërkesë për përjashtimin e tij nga shqyrtimi i çështjes. Lidhur me këtë ankesë, në vendimin e ILD argumentohet se, sipas të dhënave dhe dokumentacionit të përcjellë, mosshqyrtimi fillestar i kërkesës “Për përjashtim gjyqtari” nga gjyqtarja znj. Gentiana Xhelili, e cila i ishte shortuar e para për shqyrtim, ka ndodhur për shkak të pamundësisë objektive për procedim, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore (ajo ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në shtetin grek). Si rrjedhojë, nuk ekzistojnë fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, dhe ankesa duhet të arkivohet, bazuar në nenin 122/4 të ligjit nr. 96/2016.

IV- Informacioni periodik i Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, depozituar në ish-KLD në datën 12.06.2018, është përcjellë pranë Zyrës së ILD, ku është regjistruar me nr. 2240 prot., datë 04.05.2021. Nëpërmjet këtij informacioni janë raportuar vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara për muajin maj 2018 nga gjyqtarët K.Dh., B.Sh. dhe Gentiana Xhelili. ILD me vendimin nr. 2431/1 prot, datë 12.09.2023 ka vendosur arkivimin e ankesës me arsyetimin se vendimet gjyqësore për të cilat kishte filluar verifikimi nga Inspektorati pranë ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr.1992/1 prot., datë 30.07.2018 pasi vendimet që janë dorëzuar në kryesekretari janë jashtë afatit 5 vjeçar të parashkrimit të parashikuar nga neni 117 i ligjit 96/2016.

V- Informacioni periodik i Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, depozituar në ish-KLD në datën 12.09.2018, është përcjellë pranë Zyrës së ILD, ku është regjistruar me nr. 2239 prot., datë 04.05.2021. Nëpërmjet këtij informacioni janë raportuar vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara për muajin korrik-gusht 2018 nga gjyqtarët K.Dh., B.Sh. dhe Gentiana Xhelili. ILD me vendimin nr. 2826 prot, datë 21.10.2024 ka vendosur arkivimin e ankesës me arsyetimin se informacioni periodik i ardhur nga kryetari i gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë i referohen fakteve që kanë ndodhur jashtë afatit të parashkrimit, të parashikuar ne nenin 117 të ligjit 96/2016.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtares subjekt vlerësimi.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. Integriteti i gjyqtares**

#### **3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 5 (pesë) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 968/1 prot, datë 13.04.2023, nr. 2286/1 prot., datë 24.07.2023, nr. 827/11 prot., datë 27.07.2023, nr.2431/1 prot., datë 12.09.2023 dhe nr. 2826 prot, datë 21.10.2024, në të cilat është vendosur arkivimi pas verifikimit, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares Gentiana Xhelili, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2989/1 prot., datë 04.10.2024, rezulton se: “Në përfundim të kontrollit të plotë të deklaratave të interesave private “Periodike Vjetore 2017 – Periodike Vjetore 2020”, për këto subjekte ka rezultuar se: 1) Deklaratat e interesave private Periodike Vjetore 2017-2020, janë dorëzuar brenda afateve ligjore; 2) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; 3) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga zëvendëskryetari i gjykatës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

### **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtares, gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për

këtë tregues, pasi presumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C. Paanësia e gjyqtarës**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i zëvendëskryetarit.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 31 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës, nga të cilat 9 janë pranuar dhe 22 janë rrëzuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 55 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 31 janë pranuar dhe 24 janë rrëzuar.

Bazuar në këto të dhëna, nëpërmjet postës elektronike më datë 03.03.2026, i është kërkuar gjykatës kopje e vendimeve mbi të cilat ishte pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës, me qëllim analizimin e tyre në drejtim të shkakut të përjashtimit. Në datën 05.03.2026, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, nëpërmjet postës

elektronike, ka sqaruar se të dhënat mbi kërkesat për përjashtimin e gjyqtares, të dërguara më parë nga gjykata, mbartnin pasaktësi, pasi ato pasqyronin kërkesa me objekt përjashtim gjyqtari të shqyrtuara nga gjyqtarja në fjalë dhe jo kërkesa që kishin për objekt përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Pas verifikimit të të dhënave, gjykata ka ridërguar të dhënat statistikore të përfshira në tabelën nr. 4, nga ku rezulton si më poshtë:

- Për vitin 2017 janë paraqitur nga palët 8 kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat nuk është pranuar asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi.
- Për vitin 2018 janë paraqitur 4 kërkesa, nga të cilat 1 është pranuar dhe 3 janë rrëzuar.
- Për vitin 2019 janë paraqitur 8 kërkesa, nga të cilat 1 është pranuar dhe 7 janë rrëzuar.

Në total, për të gjithë periudhën e vlerësimit, janë paraqitur 20 kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 2 janë pranuar dhe 18 janë rrëzuar.

#### **KONKLUZIONI**

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paañesi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares (vetëm 2 kërkesa për një periudhë 3 vjeçare), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

#### **4.A. Aftësia e komunikimit**

##### ***4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja Gentiana Xhelili, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

##### ***4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B. Aftësia për të bashkëpunuar**

##### ***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

##### ***4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim korrekt me administratën gjyqësore, në funksion të krijimit të një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera**

##### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja Gentiana Xhelili, gjatë periudhës 01.01.2017–31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e pjesëmarrëses, në 24 aktivitete trajnuese të zhvilluara përgjatë kësaj periudhe, në total 41 ditë trajnimi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja nuk rezulton të ketë deklaruar pjesëmarrje në trajnime të tjera profesionale jashtë Programit të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLUZIONI**

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 24 aktivitete trajnuese të shtrira në 41 ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

##### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja nuk është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes/lehtësueses në aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo si udhëheqëse për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se “Përgjatë vitit 2017-2020 pranë meje si gjyqtare ku ushtroj detyrën në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Vlorë kanë bërë praktikën mësimore studentët e Universitetit Ismail Qemali Vlorë Fakulteti Juridik 4 studentë”. Bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur vërtetimin

nr.5346 prot., datë 07.07.2025 lëshuar nga Kancelari i Gjykatës Administrative të Shkollës së Parë Lushnjë. Lidhur me veprimtaritë e parashtruara nga gjyqtarja vlerësohet se këto veprimtari përfshihen në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, dhe do të vlerësohen në këtë tregues.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren Gentiana Xhelili duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes/lehtësueses apo udhëheqëses për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional, në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese, apo si udhëheqëse për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional, pranë Shkollës së Magjistraturës.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë, pikëzohet me 3 pikë.*

#### ***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) nga dosja personale e gjyqtares apo të dhëna nga burimet e vlerësimit, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja ka deklaruar se “Jam angazhuar në fjalime publike para studentëve për periudhën 2017-2020 në Kolegjin Universitar ‘Pavarësia Vlorë’ dhe gjithashtu pranë Shkollës Jopublike ‘Shkolla Internacional Vlorë në zbatim të edukimit të komunitetit të nxënësve të shkollës jopublike ‘Shkolla Internacional’ lidhur me konceptet ligjore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe kundravajtjeve administrative”. Bashkëlidhur formularit, gjyqtarja ka paraqitur vërtetimin e datës 13.05.2021, të lëshuar nga Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë” dhe vërtetimin nr.2685 prot., datë 14.07.2025 të Shkollës Jopublike “Shkolla internacional”.

Këto aktivitete jashtë funksionit janë deklaruar nga gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit, nga verifikimi i të dhënave për veprimtaritë jashtë funksionit, me ose pa pagesë, nuk rezultojnë që gjyqtarja t'i ketë raportuar ato, sipas nenit 9, pika 8 të ligjit 96/2016, brenda 6-mujorit të parë të pasardhës, në Këshill, për aktivitetin jashtë funksionit të papaguar që ka realizuar gjatë vitit paraardhës.

Gjithashtu, referuar dokumenteve të paraqitura nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vlerësimit, sikurse pasqyrohen në treguesin e mësipërm, rezultojnë angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale, të kontributit në ndjekjen dhe udhëheqjen e praktikave mësimore të studentëve të vitit të tretë të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, Fakulteti Juridik.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësohet dedikimi i kohës dhe përpjekjeve të gjyqtarit për përmirësimin e sistemit gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këtu përfshihen: fjalimet publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen e angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet vlerësimit të këtij treguesi.

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë që gjyqtarja të jetë angazhuar në këtë periudhë vlerësimi, në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

#### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarës, duke e pikëzuar me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

#### NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësi të profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësi të organizative të gjyqtarës	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësi personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	390	Shkëlqyeshëm

## **REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja Gentiana Xhelili të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN GENTIANA XHELILI**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>97</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %	12	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81% - 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të

					<p>çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
<b>B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<p>1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<p><b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b></p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p> <p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë</p>
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<p>1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Shumë e lartë	20	<p><b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b></p> <p>E dobët- 4 pikë</p> <p>Nën mesataren – 8 pikë</p> <p>Mesatare – 12 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 16 pikë</p> <p>Shumë e lartë - 20 pikë</p>
<b>C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<p>1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës</p>	Shumë e lartë	5	<p><b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b></p> <p>E dobët- 1 pikë</p> <p>Nën mesataren – 2 pikë</p> <p>Mesatare – 3 pikë</p>

					Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarës</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarës :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarës</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b>

		përzgjedhura me short për vlerësim			E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparencja e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë

	përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	15-120 ditë	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtares:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>	<b>390</b>
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES</b>	<b>SHKËLQYESHËM</b>

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**